

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “*Blerje konteneri për përbashkimin e situatave emergjente*”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 34221000-2(Konteniere të lëvizshëm për qëllime të veçanta)

Vlera e fondit limit: 32,099,083.25 (tridhjetë e dy milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e tre pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH. *Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 321,666.33*(treqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e tre) **Euro pa TVSH.**

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 15/08/2024 është 99.79 Lekë/Euro.**

Burimi i financimit: me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024, miratuar me VKB Nr.69, datë 27.06.2024 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.125, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024, të ndryshuar”

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në Nenin 43, pika 2, si dhe Nenit 43, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

-
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP; Nenit 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe ne Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ne Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” (i ndryshuar), Neni 3.1/a, b, c dhe Neni 40, ne Ligjin Nr. 131/2015 “Per QKB” (i ndryshuar), si dhe ne ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “Per QKR” (i ndryshuar).

2.3Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a.Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, në vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së llogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **12,839,633.3** (dymbëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre pikë tre) **lekë pa TVSH, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 128,666.5**(njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesë) **Euro pa TVSH, *Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 15/08/2024 është 99.79Lekë/Euro;** të realizuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë Mallrash;
 - Vërtetim lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të jetë shënuar qartë vlera, afati i përfundimit të kontratës;
 - Fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të jetë shënuar data, shumat dhe sasia e mallit të furnizuar.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jetë shënuar data, shumat dhe sasia e mallit të furnizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që

dëshmite për furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate furnizimi, per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit , nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2. Një punësim mesatar i të paktën **10** (dhjetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislativi në fuqi, *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 40, pika 5, gërma ”c” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me objektin e prokurimit si dhe me kohëzgjatjen e kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit), gjatë të cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 40, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri i jep siguri

AK se artikujve gjate periudhes se garancise do t'u mundesohet riparimi dhe mirembajtja e tyre nga ofertuesi.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merrr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të të gjithë artikujve në ambientet e përcaktuara CEF, Bashkia Tiranë, të evidentuar në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 40, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e ketij kriteri i jep siguri AK se Operatori ekonomik merr persiper te kryeje sherbimin e transportit te artikujve ne ambjentet e parashikuara ne DST.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:
 - a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave që do të marrë përsipër të furnizojë sipas akt marrëveshjes).
 - b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave që do të marrë përsipër të furnizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentim: Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 3 (tre) mjete transporti me kapacitet mbajtëse 20-25 ton të përshtatshëm për transport të këtyre konteniereve. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qera:
 - a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit

(akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjete, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjete (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet ku të jetë e targa e tij.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 40, pika 5, germa ”ç” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Përcaktimi i llojit dhe numrit të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës, është mbështetur referuar objektit të prokurimit si dhe kohezgjatjes së kontratës të parashikuar në DST.

7. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës shofer.

Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

a) kontratë individuale të punës;

b) leje drejtimi, *(Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit Shofere, emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së lejes së drejtimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme bazohet në Nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 40, pika 5, germa ”b” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është vendosur në harmonizim të plotë me mjetet e kerkuara sipas pikës 7.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti Kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës duhet ti dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (e mail zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, si dhe dokumentet duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës .